

Komuna e Kaçanikut: problemet kryesore dhe trendët buxhetor

Hyrje

1. Komuna e Kaçanikut udhëhiqet nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Kryetar aktual i kësaj komune është Besim Ilazi. Kaçaniku, i është nënshtruar zgjedhjeve të jashtëzakonshme, në gjysmën e parë të vitit 2012, pas shpalljes së aktgjykimit ndaj ish Kryetarit të kësaj komune, Xhabir Zharku, i cili është gjetur fajtor për kërcënim, shantazh dhe armëmbajtje pa leje.
2. Nga regjistrimi i fundit i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, Kaçaniku ka 33.409 banorë.¹
3. Kaçaniku ka aktualisht shtatë drejtori komunale. Kuvendi Komunal është i përbërjes së zgjedhjeve të 2009, ngase zgjedhjet e 2012 kanë qenë vetëm për pozitën e Kryetarit. Kuvendi në Kaçanik përbëhet prej 27 këshilltareve komunal, prej tyre 13 janë nga PDK, shtatë nga AAK, katër nga LDK, dy nga AKR dhe një këshilltar nga LDD.
4. Në hulumtimin e zhvilluar nga Instituti GAP në fund të vitit 2009, problemet kryesore në komunën e Kaçanikut kanë qenë papunësia dhe mos zhvillimi ekonomik, ndotja e ambientit, mungesa e shërbimeve shëndetësore, si dhe rritja e rasteve të delikuençës tek të rinjtë.²
5. Sipas hulumtimit të UNDP-së, Mozaiku i Kosovës 2012, 83% e banorëve të Kaçanikut besojnë se autoritetet e tyre lokale kanë kapacitet për të zgjidhur problemet në komunën e tyre, kurse 8% në krahasim me mesataren e Kosovës 15%, mendojnë se vetëm pushteti qendror mund t'i zgjidhë këto probleme.³

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2011. Burimi: http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf

² Instituti GAP. Raporti i Komunës së Kaçanikut i vitit 2009. Fq 7. Burimi: http://www.institutigap.org/documents/54003_Ka%C3%A7aniku-raporti%20komunal.pdf

³ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 27. Burimi: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf

Problemet kryesore të Komunës së Kaçanikut 2013

- 1. Mungesa e ujësjellësit.** Në komunën e Kaçanikut vetëm qyteti dhe tri fshatra (Stagovë, Begracë, dhe Korboliq) e kanë të instaluar sistemin e ujësjellësit. Edhe në këto lokalitete ku ekziston i instaluar sistemi i ujësjellësit, shqetësimi ekziston ngase gypat e sistemit primar të ujësjellësit janë të përbërë nga azbesti, material i cili konsiderohet i dëmshëm për shëndetin. Në raportin e UNDP-së, potencohet se rreth 46% e qytetarëve të Kaçanikut nuk janë të lidhur në ujësjellësin publik. Nga ky hulumtim tregohet se rreth 66% e familjeve të lidhura me ujësjellësin publik kanë furnizim të pakufizuar me ujë në krahasim me mesataren e Kosovës 42%. Dhjetë përqind raportuan se kanë pasur ndërprerje të furnizimit me ujë për 1 deri në 4 orë në ditë, 10% prej 5 deri në 10 orë në ditë, 5% kanë ndërprerje të furnizimit të ujit më të gjata se 11 orë në ditë, kurse për 6% ndërprerjet e ujit zgjasin më shumë se 3 ore në ditë, në çdo shkycje.⁴
- 2. Menaxhimi me mbeturina.** Komuna e Kaçanikut menaxhimin e mbeturinave e ka të rregulluar përmes kompanisë rajonale “Pastërtia”, por edhe për kundër kësaj vetëm në 5 fshatra mbledhen mbeturinat në mënyrë të rregullt (Niçevc, Biçevc, Elezaj, Duraj dhe Kacanik i Vjetër). Në oborrin e kompanisë “Pastërtia” mund të hasësh kontejnerë të shumtë të papërdorur përderisa fshatrat nuk e kanë të zgjidhur akoma këtë problem. Deponi të egra janë krijuar në zonat përreth vendbanimeve Kotlinë, Nikaj, Rekë, Sllatinë, Saponicë, Stagovë.⁵
- 3. Mungesa e kanalizimeve.** Disa prej fshatrave të cilat nuk janë të kyçur në sistemin e kanalizimit janë fshati Doganë, Biqec, Begracë. Sipas raportit të UNDP-së, 36% e qytetarëve në Kaçanik nuk janë të kënaqur me gjendjen e kanalizimeve në vendbanimin e tyre.⁶
- 4. Ndotja e lumenjve.** Lumi “Nerodime” i cili kalon në mes të qytetit kundërmon për arsye të derdhjes së kanalizimit në të. Në të njëjtën gjendje ndodhet edhe lumi “Lepenc”. Që në të dy këta

⁴ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 67. Burimi:http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf

⁵ Komuna e Kaçanikut. Faqja zyrtare. Debatohet për mënyrën e menaxhimit të mbeturinave në fshatin Biçec. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/kacanik/News/Debatohen-menytrat-e-menaxhimit-te-mbeturinave-ne-f.aspx>

⁶ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 68. Burimi:http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf

lumenj hasen të derdhura mbeturina përgjatë gjithë gjatësisë së tyre, përjashtimisht zonës së qendrës së qytetit, ku nuk hasen të derdhura mbeturina, por hasen gypat e kanalizimeve të cilat i sjellin në lum ujërat e zeza. Banorët e Kaçanikut të vjetër dhe Stagovës, fshatra në të cilat kalon lumi “Nerodime”, ankohen për kundërmim të lumit pasi që përveç ndotjes nga fshatrat e Kaçanikut derdhen edhe kanalizimet e disa prej fshatrave të komunës së Ferizajt. Gjatë periudhës së verës, banorët nuk mund të hapin dritaret e shtëpive nga era e keqe e lumit.

- 5. Ndotja e ajrit dhe ndotja industriale e lumit Lepenc.** Fabrika për blloqet e gaso-betonit “Silcapor” dhe ajo për prodhimin e gëlqeres “Lepenci i Ri”, cilësohen si ndotësit kryesor të ajrit në këtë komunë. Përpos ndotjes së ajrit, këto fabrika bëjnë edhe ndotjen industriale të lumit Lepenc dhe Nerodime duke hedhur në këta lumenj materie të ndryshme kimike. Sipas hulumtimit të UNDP-së, 10% e banorëve në Kaçanik e kanë konsideruar problem cilësinë e ujit në qytetin e tyre, përderisa 23% e kanë konsideruar të ndotur lagjen apo qytetin ku jetojnë.⁷
- 6. Mungesa e mureve mbrojtëse të rrugëve malore.** Komuna e Kaçanikut, një numër të konsiderueshëm të fshatrave i ka malore, andaj infrastruktura rrugore gjithsesi do të duhet të inkuadrojë edhe muret mbrojtëse të rrugëve për të evituar shembjen e dheut apo gurëve nga lartësitë e maleve. Fshati ku kërkohet investim i kësaj natyre është rruga për fshatrat Gajre dhe Vata, fshatra këto malore, ku përgjatë kësaj rruge ka shembje të shumta të dheut të cilat rrezikojnë qytetarin dhe përpos kësaj në mungesë të mbrojtësve anësore mund të vjen edhe deri tek mbyllja permanente e kësaj rruge.
- 7. Mungesa e rrugëve të asfaltuara dhe trotuareve.** Kaçaniku si qytet ka mungesë të trotuareve. Rrugëve të cilat ju mungon trotuari janë rruga “Qamil Ilazi” dhe “Sali Bajra”. Ndërsa fshatrat të cilat kanë mungesë të rrugëve të asfaltuara janë Gjurgjedell, Rekë, Dura, Gabricë, Drenogllavë. Ndërsa sa i përket lagjeve në qytetin e Kaçanikut të gjitha rrugët janë të asfaltuara përveç një pjesë e rrugës “Idriz Seferi”. Në bazë të një hulumtimi të zhvilluar me banorët e Komunës së Kaçanikut nga organizata DEMI/USAID, 22% e banorëve janë deklaruar të pakënaqur me rrugët në vendbanimin e tyre, përderisa përqindja e atyre që janë të pakënaqur me trotuaret në këtë komunë është 52%.⁸

⁷ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 69. Burimi:http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf

⁸ Programi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim (USAID). Raporti i anketimit mbi kënaqshme rinë e qytetarëve me shërbimet komunale. Fq 29. Burimi: http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen_Satisfaction_Report-Shqip.pdf

8. Mungesë të mjekëve në QKMF. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Kaçanik ka mungesë të mjekëve, sidomos nevoja më e madhe paraqitet për gjinekolog dhe ortoped. Ndërsa sa i përket qasjes së qytetarëve në spitale, sipas raportit të UNDP-së, banorët e Kaçanikut kanë qasje dukshëm më të keqe në spitale në krahasim me mesataren e Kosovës, duke marrë parasysh afërsinë gjeografike, spitali më i afërt për banorët e Kaçanikut është 64 minuta (krahasuar me mesataren e Kosovës prej 38 minuta).⁹

Gjërat pozitive të cilat duhet mirëmbajtur

Trashëgimia kulturore. Ruajtja e trashëgimisë kulturore, si Xhamia e “Koxha Sinan Pashës” dhe Kalaja e qytetit, janë konsideruar si objekte të cilave duhet ti kushtohet më shumë përkujdesje institucionale.


Trendet Buxhetore në Komunën e Kaçanikut

Komuna e Kaçanikut në vitin 2013 ka planifikuar 5.6 milion euro buxhet. Krahasuar me vitin 2010, komuna ka pasur një rritje të buxhetit për 1.2 milion euro (27%). Të hyrat vetanake në vitin 2012 kanë qenë 426 mijë euro apo 89 mijë euro më pak se në vitin 2010. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm¹⁰ ka rekomanduar që kjo komunë të përmirësojë sistemin e faturimit dhe mbledhjen e taksave të ndryshme.

⁹ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 69. Burimi:http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf

¹⁰ ZAP, Raporti i Auditimi mbi Pasqyrat Financiare të Komunës së Kaçanikut Mbyllur me 31 Dhjetor 2012, 06 Gusht 2013 http://oag-rks.org/repository/docs/Kacanik_Report_ALB_125403.pdf


Figura 1. Buxheti i Komunës së Kaçanikut 2013



Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?kacanik/2013#/~kacanik>.

Nga grafikoni rreth trendeve të ndarjeve buxhetore, shohim se përveç rritjes së pagave, bie në pah edhe një rënie e theksueshme prej 448 mijë euro apo 31% e investimeve kapitale në vitin 2012. Kur jemi tek shpenzimet gjatë vitit 2012, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka gjetur raste: kur përfituesi i tenderit nuk kishte ndonjë reference apo kontratë të mëhershme për punën e tij; 2) vonesa në kryerjen e punëve; 3) vlera të kontratës më të larta se parashikimi; 4) kualitet i dobët i punëve të kryera ndërsa pagesa është kryer e plotë etj.

Figura 2. Trendet e ndarjeve buxhetore 2010-2013



Në krahasim me buxhetin e vlerësuar të vitit 2016 me atë të 2013, Komuna e Kaçanikut planifikon t'i rrisë të hyrat për 16%. Përveç rritjes së të hyrave vetanake, një pjesë e madhe e kësaj rritje vlerësohet të vijë nga granti qeveritar. Është interesant të përmendet se kjo komunë planifikon t'i rrisë vetëm shpenzimet kapitale, përderisa të gjitha kategoritë tjera do të mbesin saktësisht të njëjta gjate viteve 2014-2016.

Tabela 1. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve 2014-2013

Të Hyrat Totale	2014	2015	2016
Të hyrat totale	6.215.408	6.367.943	6.496.169
Të hyrat vetanake	630.000	630.000	635.000
Grantet	5.585.408	5.737.943	5.861.169
Shpenzimet Totale	6.215.408	6.370.943	6.496.169
Pagat dhe Mëditjet	3.758.372	3.758.372	3.758.372
Mallrat dhe Shërbimet	568.382	568.382	568.382
Shpenzimet Komunale	128.757	128.757	128.757
Subvencionet dhe Transferet	175.000	175.000	175.000
Shpenzimet Kapitale	1.584.897	1.740.432	1.865.658

Metodologjia e hartimit të raportit

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe monitorimin e fushatave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës hulumtuese dhe analitike, janë grumbulluar informata për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Kaçanikut është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj. Të gjeturat e GAP janë mbështetur me të dhënat kuantitative të siguruara përmes anketës së zhvilluar nga ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus) dhe DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012).



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.